

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2022

DREJTORIA E SIGURIMIT TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1.	01.02.2022	Kërkesë për Informacion M.B.	08.02.2022	Në përgjigje të kërkesës Tuaj, datë 01.02.2022, me lëndë “Kërkese për informacion” dhe në mbështetje të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën Në mbështetje të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.03.2015 e informimit” Ju informoj se, Nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) nuk janë hartuar raporte verifikimi për subjektet e cituara në kërkesën tuaj, pasi nuk janë subjekte në kuadër të ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.	E plotë	Nuk ka
2.	02.02.2022	Kërkesë për informacion A.H	16.02.2022	Në përgjigje të kërkesës Tuaj, datë 01.02.2022, me lëndë “Kërkese për informacion” dhe në mbështetje të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” Ju informojmë se, Kërkesa për informacion në përputhje me nenin 11 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuarit dhe nënshkrimin e tij. Gjithsesi, në lidhje me kërkesën tuaj Ju informojmë se, cilat janë arsyet e refuzimit të Certifikatës së Sigurimit të Personelit, ju informojmë se, DSIK është mbështetur në shkaqet ligjore të përcaktuara në nenet 13 “Kërkesat e përgjithshme të vlerësimit të sigurisë” dhe 14 “Kriteret themelore të vlerësimit të sigurisë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.	E plotë	Nuk ka

				<p>188, datë 4.03.2015 “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”.</p> <p>Vlerësimi i sigurisë nga DSIK është bazuar në informacione të klasifikuara, të përfuara nga autoritetet verifikuese dhe në zbatim të Vendimit nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror””, çdo person fizik dhe çdo punonjës apo strukturë e interesuar brenda ministrisë apo institucionit ka të drejtën për të paraqitur kërkesë për deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” me qëllim marrjen në shqyrtim të kërkesës nga Komisioni i Deklasifikimit, Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror” (KDZH).</p> <p>Në lidhje me pyetjen tuaj se, a kanë të drejtën e lirimit nga detyra eprorët pasi refuzohet pajisja me CSP, ju sqarojmë se:</p> <p>DSIK në asnjë vendim të saj, nuk kërkon largimin nga detyra të personave që nuk plotësojnë kriteret për t’u pajisur me CSP, por rekomandon marrjen e masave që personi të mos njihet me informacion të klasifikuar.</p> <p>DSIK, nuk ka kompetencë ligjore dhe nuk merr vendime për largimin apo qëndrimin në detyrë të nëpunësve/punonjesve pasi vendimi përfundimtar për marrëdhëniet e punësimit të një nëpunësi/punonjësi, mbetet në kompetencë të institucionit punëdhënës.</p>		
3.	04.02.2022	Kërkesë për hetimin administrativ të procedurës së pengimit të rinovimit të	17.02.2022	<p>Në përgjigje të shkresës datë 04.02.2022, me lëndë “Kërkesë për hetimin administrativ të procedurës së pengimit të rinovimit të certifikatës së sigurisë nga ana e strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes për kapitenin e rangut të parë A.M” dhe në mbështetje të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” Ju</p>	E plotë	Nuk ka

		Certifikatës së Sigurisë nga ana e strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes për Kapitenin e Rangut të Parë A.M		<p>informojmë se, DSIK ndjek procedurat për lëshimin, ripajsjen, refuzimin, heqjen dhe pezullimin e “Certifikatës së sigurimit të personelit”, mbështetur në Vendimin nr. 188, datë 4.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”.</p> <p>Në zbatim të nenit 8, germa a, të Vendimit të sipërcituar, DSIK ndjek procedurat për pajisje me Certifikatë të Sigurimit të Personelit pas kërkesës së titullarëve të ministrive dhe institucioneve shtetërore ose personave të autorizuar për punonjësit dhe stafet e tyre, të kontraktuarit ose kategoritë e individëve të parashikuar për të marrë pjese në një prokurim të klasifikuar.</p> <p>Pas kërkesës së Ministrisë së Mbrojtjes në mbështetje të nenit 8, germa a, të VKM nr. 188, datë 4.03.2015, DSIK filloi verifikimin e sigurisë për Z. Meçollari.</p> <p>Pas njoftimit zyrtar të Ministrisë së Mbrojtjes se ju nuk jeni më në marrëdhënie pune me Ministrinë e Mbrojtjes dhe rrjedhimisht nuk keni nevojë për njohje me informacionin e klasifikuar, DSIK ndërpreu procedurat e verifikimit të sigurisë. Verifikimi i sigurisë kryhet për ata individë të cilët për shkak të funksionit të caktuar zyrtar dhe me qëllim përmbushjen e një detyre funksionale do të kenë akses tek informacioni i klasifikuar. Kur ju të jeni në kushtet e nevojës për njohje, DSIK do kryej verifikimin e sigurisë në mbështetje të legjislacionit në fuqi.</p>		
4.	17.02.2022	Kërkoj të dhëna dhe akte shkresore E.I	18.02.2022	Në përgjigje të kërkesës tuaj datë 17.02.2022, me lëndë “Kërkoj të dhëna dhe akte shkresore”, në mbështetje të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 8457, datë	E plotë	Nuk ka

				<p>11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, i ndryshuar, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Ju informojmë se:</p> <p>Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar është autoriteti përgjegjës për kontrollin e figurës dhe hartimin e raporteve të Kontrollit të Figurës për subjektet e rivlerësimit referuar ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>Në lidhje me kërkesën për kopje të raporteve të Grupit të Punës për Kontrollin e Figurës, ju vëmë në dispozicion:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Raportin nr. 10951 Prot., datë 29.10.2019 deklasifikuar pjesërisht me vendim të Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit (KDZH) të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror” nr. 274, datë 29.10.2019. • Raportin nr. 11744 Prot., datë 30.10.2017 deklasifikuar plotësisht me vendim të Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit (KDZH) të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror” nr. 37, datë 18.02.2022. <p>Në lidhje me kërkesën për kopje të të dhënave të dërguara nga komisioni për vlerësim dhe praktikën e plotë që është ndjekur, ju bëjmë me dije se, korrespondenca ndërmjet DSIK, KPK dhe Autoriteteve Verifikuese, është e klasifikuar sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar dhe nuk mund t’ju vihet në dispozicion.</p> <p>Referuar nenit 21, të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, i ndryshuar, një person mund të njihet me informacion të klasifikuar nëse ai siguron një të drejtë njohjeje nga një drejtues institucioni apo personi, të cilit me ligj i është deleguar një e drejtë e</p>	
--	--	--	--	---	--

				<p>tillë, kur:</p> <ol style="list-style-type: none"> personi ka nevojë për njohje informacioni për përmbushjen e interesave dhe qëllimeve të ligjshme; personi ka nënshkruar një marrëveshje për mosekspozimin e informacionit; personi ka garanci sigurie. personi ka zotësi për të vepruar <p>E drejta e njohjes me informacionin e klasifikuar ushtrohet për shkak të detyrës/funksionit nëse sigurohet një e drejtë njohjeje nga një drejtues institucioni apo personi, të cilit me ligj i është deleguar një e drejtë e tillë dhe nëse plotësohen kushtet e përcaktuara në nenin e sipërcituar.</p>		
5.	18.02.2022	Kërkesë për informacion D.T	25.02.2022	<p>Në përgjigje të kërkesës Tuaj, datë 18.02.2022, me lëndë “Kërkese për informacion” dhe në mbështetje të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” Ju informoj se,</p> <p>DSIK përcakton masat mbrojtëse dhe procedurat e parandalimit nga përhapja e paautorizuar, humbja, apo shkeljet e sigurisë së informacionit të klasifikuar, i cili trajtohet në kushtet e zbatimit të një projekt/program/kontratë/nënkontratë të klasifikuar.</p> <p>DSIK nuk disponon informacionin për numrin e përgjithshëm të prokurimeve të cilat lidhin autoritetet kontraktore me operatorët ekonomikë, por vetem përcakton masat mbrojtëse për informacionin e klasifikuar dhe i mbikëqyr gjatë inspektimeve të kryera.</p> <p>Deri në miratimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 542, datë 29.9.2021 “Për rregullat, procedurat dhe kërkesat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”, DSIK ka patur detyrimin e përcakimit të masave mbrojtëse për</p>	E plotë	Nuk ka

			<p>informacionin e klasifikuar gjatë kryerjes së një prokurimi të klasifikuar.</p> <p>Në lidhje me kërkesës tuaj, DSIK ju vë në dispozicion listën e institucioneve të cilat prodhojnë informacion të klasifikuar. Mund t'i drejtoheni institucioneve të listuara, në vijim:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Institucioni i Presidentit të Republikës së Shqipërisë; 2. Kuvendi i Shqipërisë; 3. Kryeministria; 4. Minsitria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Pqrfaqësitë Diplomatike të RSH-së të akredituara jashtë vendit; 5. Ministria e Mbrojtjes dhe strukturat në varësi të saj; 6. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe strukturat në varësi të saj, Garda e Republikës dhe Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave në Ministrinë e Brendshme; 7. Ministria e Drejtësisë, Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve; 8. Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme 10. e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, 9. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, strukturat në varësi të saj, 10. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, 11. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, 12. Ministria e Kulturës, 13. Shërbimi Informativ i Shtetit dhe Strukturat në varësi të tij, 14. Prokuroria e Përgjithshme dhe strukturat në varësi të saj, 		
--	--	--	--	--	--

				<p>15. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit,</p> <p>16. Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike,</p> <p>17. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit,</p> <p>18. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit,</p> <p>19. Banka e Shqipërisë,</p> <p>20. Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare,</p> <p>21. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar,</p> <p>22. Këshilli i Lartë Gjyqësor,</p> <p>23. Këshilli i Lartë i Prokurorisë,</p> <p>24. Departamenti i Administratës Publike,</p> <p>25. Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit.</p> <p>Në lidhje me pyetjen nr. 3, ju informojmë se, nuk ka procedurë publike e cila është e klasifikuar në nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret”.</p>		
6.	03.03.2022	Kërkesë për t’u njohur me Raportin e Kontrollit të Figurës të GP nr. 1451, datë 11.02.2021 me lëndë “Dërgohet raporti i kontrollit figurës së subjektit të rivlerësimit S.H”.	09.03.2022	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj datë 3.03.2022, me lëndë “Kërkesë për t’u njohur me Raportin e GP nr. 1451 dt. 11.02.2021 me lëndë “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Znj. Saemira Jorgji Hila””, në mbështetje të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror””, Ju vëmë në dispozicion:</p> <p>Raportin nr. 1451 Prot., datë 11.02.2021 deklasifikuar pjesërisht me vendim të Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit (KDZH) të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror” nr.</p>	E plotë	Nuk ka

				863, datë 18.03.2021.		
7.	24.02.2022	Kthim përgjigje shkresës nr. 410, datë 17.02.2022 A.M	09.03.2022	<p>Në përgjigje të shkresës datë 24.02.2022, me lëndë “Kthim përgjigje shkresës nr. 410, datë 17.02.2022” dhe në mbështetje të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” Ju informojmë se,</p> <p>Në zbatim të nenit 8, germa a të Vendimit nr. 188, datë 4.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit” DSIK ndjek procedurat për lëshimin, ripajisjen, refuzimin, heqjen dhe pezullimin e “Certifikatës së sigurimit të personelit”, pas kërkesës së titullarëve të ministrive dhe institucioneve shtetërore ose personave të autorizuar për punonjësit dhe stafet e tyre, të kontraktuarit ose kategoritë e individëve të parashikuar për të marrë pjese në një prokurim të klasifikuar.</p> <p>Në rastet kur, kërkesa e aplikimit për pajisje me CSP kryhet sipas kushtit të parashikuar në shkronjën “a” të nenit 8, titullari i ministrisë apo i institucionit shtetëror ose përfaqësuesi ligjor i një operatori ekonomik vendas, marrin masa përmes OS-së, OSI-së apo strukturës së ngarkuar për kryerjen e verifikimit paraprak, në mbështetje të nenit 9 të vendimit të sipërcituar. Është detyrë dhe përgjegjësi e institucioneve shtetërore që paraqesin aplikimin në DSIK kryerja e verifikimit paraprak.</p> <p>Kërkesa juaj ka për objekt veprimet e kryera nga institucioni aplikues. Objekti i inspektimeve të DSIK fillon pasi është paraqitur kërkesa zyrtarisht në DSIK. Afati për kryerjen e verifikimit të sigurisë fillon vetëm pas dorëzimit të dokumentacionit të plotë dhe pranimin nga DSIK.</p> <p>Për sa më sipër, për shkak se kërkesa juaj ka për objekt verifikimin paraprak të kryer nga MM,</p>	E plotë	Nuk ka

				sugjerojmë t'i drejtoheni institucionit përkatës për kryerjen e hetimit administrativ të kërkuar nga ana juaj.		
8.	08.03.2022	Kërkesë për informacion A.M	10.03.2022	<p>Në përgjigje të kërkesës Tuaj, datë 08.03.2022, me lëndë “Kërkese për informacion” dhe në mbështetje të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” Ju informojmë se,</p> <p>Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar kryen detyrat e përcaktuara në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, i ndryshuar dhe ligjin Nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>Me verifikim të sigurisë kuptohet tërësia e masave dhe e procedurave të aplikuara ndaj një individi, mbi bazën e të cilave do të vlerësohet lëshimi, refuzimi, pezullimi i përkohshëm ose heqja e “Certifikatës së Sigurimit të Personelit”.</p> <p>Verifikimi i sigurisë dhe mbledhja e informacioneve, kryhet për ata individë të cilët për shkak të funksionit të caktuar zyrtar dhe me qëllim përmbushjen e një detyre funksionale do të kenë akses tek informacioni i klasifikuar.</p> <p>Gjithashtu, DSIK kryen verifikimin e subjekteve të rivlerësimit, gjyqtarëve dhe prokurorëve në zbatim të detyrimeve të ligjit Nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>DSIK nuk kryen verifikimin e pastërtisë së figurës ndaj jush dhe nuk mbledh apo verifikon informacion në ngarkimin tuaj, pasi nuk jeni subjekt i ligjeve të sipërcituara.</p>	E plotë	Nuk ka
9.	15.03.2022	Ankesë në lidhje me pajisjen me Certifikatën	30.03.2022	Në përgjigje të kërkesës Tuaj, datë 15.03.2022, me lëndë “Ankesë në lidhje me pajisjen me Certifikatën	E plotë	Nuk ka

		e Sigurimit të Personelit GJ.SH		e Sigurimit të Personelit”, Ju informojmë se, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka marrë kërkesës tuaj dhe është në proces verifikimi në bashkëpunim me institucionet e tjera shtetërore, në mbështetje të kërkesave të legjislacionit në fuqi.		
10.	30.03.2022	Informacion urgjent V.K	30.03.2022	Në përgjigje të kërkesës datë 30.03.2022, me lëndë “Informacion urgjent”, Ju informojmë se: Kërkesa për informacion në përputhje me nenin 11 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuesit dhe nënshkrimin e tij. Në zbatim të pikës 4 të nenit 14 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, për arsye se kërkesa për informim nuk përmban elementet e mësipërme, Ju refuzohet dhënia e tij në formën e kërkuar. Kërkesa për informim duhet të përmbajë: a) emrin dhe mbiemrin e kërkuesit; b) adresën postare ose elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni; c) përshkrimin e informacionit që kërkohet; d) formatin në të cilin preferohet informa- cionin; e) çdo të dhënë që kërkuesi gjykon se mund të ndihmojë në identifikimin e informacionit të kërkuar. Ndaj refuzimit të kërkesës Tuaj, mund të ankoheni pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me nenin 24, pika 1 dhe pika 2, germa a të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.	E plotë	Nuk ka
11.	11.04.2022	Kërkesë për t’u njohur me një vendim të marrë	26.04.2022	Në përgjigje të kërkesës Tuaj, me lëndë “Kërkesë për t’u njohur me një vendim të marrë nga DSIK”, në	E plotë	Nuk ka

		nga DSIK A.P		mbështetje të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, i ndryshuar dhe ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, bashkëlidhur gjeni vendimin nr. 82, datë 04.04.2022 “Për refuzimin e certifikatës së sigurimit të personelit për Z. A.P”.		
12.	13.05.2022	Kërkesë për vënie në dispozicion të Raportit të Kontrollit të Figurës J.XH	23.05.2022	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj datë 13.05.2022, në mbështetje të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror””, Ju vëmë në dispozicion:</p> <ul style="list-style-type: none"> Raportin nr. 5908 Prot., datë 21.06.2021 deklasifikuar pjesërisht me vendim të Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit (KDZH) të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror” nr. 2206, datë 24.06.2021. <p>Në lidhje me kërkesën për vënie në dispozicion të informacioneve të dërguara nga DSIK pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ju informojmë se në mbështetje të Ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, i ndryshuar, dokumentet e kërkuara nga ana juaj janë të klasifikuara dhe nuk mund t’ju vihen në dispozicion.</p>	E plotë	Nuk ka
13.	23.05.2022	Kërkesë për informacion P.P	26.05.2022	<p>Lidhur me kërkesën Tuaj, të dërguar me e-mail në sekretaria@ nsa.gov.al, me 23 Maj 2022, sqarojmë si më poshtë:</p> <p>Në nenin 21, të Ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999, "Per informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror, i ndryshuar dhe nenin 4 të VKM nr. 188, datë 4.3.2015 te Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit"; përcaktohet se:</p>	E plotë	Nuk ka

				<p>Një person mund të njihet me një informacion të klasifikuar nëse ai siguron një të drejtë njohjeje nga një drejtues institucioni apo personi, të cilit me ligj i është deleguar një e drejtë e tillë, kur</p> <p>a) personi ka nevojë për njohje informacioni për përmbushjen e interesave dhe qëllimeve të ligjshme;</p> <p>b) personi ka nënshkruar një marrëveshje për mos ekspozimin e informacionit;</p> <p>c) personi ka garanci sigurie.</p> <p>ç) personi ka zotësi për të vepruar. Sa më sipër, përgjegjësi i sekretarisë së arkivit në Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza, nuk është në kushtet e "nevojës për njohje për të pasur akses tek informacioni i klasifikuar, në kuadrin e një pozicioni të caktuar dhe me qëllim përmbushjen e një detyre specifike.</p> <p>Më shumë detaje, informacion dhe ligjore e gjeni në faqen e internetit të institucionit</p>		
14.	08.06.2022	Pyetje rreth formularit të sigurisë N.XH	09.06.2022	<p>Ju bej me dije se në vendimin, 188, datë 04.03.2015 "Per miratimin e rregullave per sigurimin personelit", nenin 19 "Rrethi i personave që verifikohen", percaktohet se: Verifikimi i sigurisë përfshin verifikimin e aplikantit dhe të lidhjeve të ngushta të përcaktuara në shkronjat "b" e "c", të këtij neni. Verifikimi i sigurisë së lidhjeve të ngushta kryhet për të arritur në përfundimin nëse ekziston rreziku real që aplikantit t'i bëhet presion përmes këtyre lidhjeve, të cilat në bazë të verifikimeve të sigurisë, mund të rezultojnë të cënueshme nga shërbimet e huaja jomiqësore, grupet terroriste apo organizatat e tjera kriminale. Verifikimi i sigurisë përfshin:</p> <p>a) vetëm personin aplikues, kur kërkohet njohja me informacionin e klasifikuar, të nivelit Konfidencial,</p> <p>b) personin aplikues, fëmijet, bashkëshortin bashkëshorten, bashkëjetuesin/bashkëjetuesja kur kërkohet njohja me informacionin e klasifikuar e</p>	E plotë	Nuk ka

				nivelit "Sekret", c)personin aplikues, fëmijët, bashkëshortin/bashkëshorten, bashkëjetuesin/bashkëjetuesen, prindërit si dhe personat e tjerë që jetojnë së bashku në së njëjtën familje kur kërkohet njohja me informacionin e klasifikuar të nivelit "Tepër secret". Për një informacion më të detajuar dhe plotësim më të saktë të pyetësorit të sigurisë jeni të lutur që të paraqiteni në DSIK, ditën e premtë nga ora 10:00 - 13:00, për të marrë sqarimet e nevojshme.		
15.	14.06.2022	Kërkohen akte E.K	15.06.2022	Bazuar në ligjin 119/2014 "Për të drejtën për informim" dhe në përgjigje të kërkesës Tuaj me lëndë "Kërkohen akte", Datë 13.06.2022, nëpërmjet së cilës kërkohen akte, bashkëlidhur gjeni kopjen e Raporteve të Kontrollit të Figurës si më poshtë: 1.Raporti i Kontrollit të Figurës nr. 12455, datë 02.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. 273 prot., datë 27.10.2021 të Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar "Sekret shtetëror". 2.Raporti i Kontrollit të Figurës nr. 1265, datë 02.03.2022, deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. 904 prot., datë 12.04.2022 të Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar "Sekret shtetëror".	E plotë	Nuk ka
16.	13.07.2022	Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion e dokumentacionit A.B Birn	14.07.2022	Në vijim të kërkesës Tuaj me object "Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion e dokumentacionit", të dates 13.07.2022, bashkëlidhur këtij emaili ju dërgojmë Raportet e Kontrollit të Figurës: Raporti i Kontrollit të Figurës nr.11717, datë 30.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH nr. 581 prot., datë 20.02.2018. Raporti i Kontrollit të Figurës nr. 1404, datë 21.02.2019, deklasifikuar pjesërisht me vendimin e KDZH nr. 278, datë 25.02.2019. Këto raporte janë të deklasifikuara dhe të anonimizuara në përputhje me	E plotë	Nuk ka

				ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.		
17.	01.08.2022	Kërkesë për sqarim K.C	08.08.2022	<p>Në përgjigje të kërkesës Tuaj, nr. 155 prot., datë 01.08.2022 më lëndë “<i>Kërkesë për sqarim</i>”, ju bëjmë me dije se:</p> <p>1. “Projektligji për informacionin e klasifikuar”, për të cilin jeni informuar se është depozituar në Kuvendin e Shqipërisë, aktualisht është një projektligj pa fuqi ligjore pasi duhet të miratohet dhe të hyjë në fuqi, pasi të jenë ezauruar të gjitha procedurat ligjore për miratimin e një projektligji sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe akteve nënligjore në fuqi, të cilat normojnë procesin që duhet të kalojë një projektakt për të marrë fuqi juridike. Derisa të hyjë në fuqi projektligji “Për informacionin e klasifikuar”, ligji nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, i ndryshuar, ka fuqi të plotë juridike dhe zbatohet për çdo parashikim të tij.</p> <p>2. Në lidhje me kriteret që duhet të plotësojë shoqëria juaj për t’u pajisur me “Certifikatë Sigurie Industriale (CSI)”, më qëllim që të marrë pjesë në procedura prokurimi në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmbajnë informacion të klasifikuar duhet që të plotësohen kërkesat e parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 542, datë 29.09.2021 “Për rregullat, procedurat dhe kërkesat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”.</p> <p>Sqarojmë se, detaje të hollësishme lidhur me standartet për sigurimin e informacionit të klasifikuar në kuadrin e prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë që përmbajnë këto informacione mund t’i gjeni në adresën zyrtare www.nsa.gov.al. Në këtë adresë do të gjeni edhe modelet e kërkesave dhe dokumentacionit të kërkuar për OE të interesuar për</p>	E plotë	Nuk ka

				të aplikuar për t'u pajisur me CSI. DSIK, është e gatshme që të asistojë të gjithë operatorët ekonomik të interesuar çdo ditë të premtë gjatë orarit zyrtar 10:00 – 12:00.		
18.	22.08.2022	Kërkohet Raporti i DSIK M.B	01.09.2022	Bazuar në ligjin 119/2014 “Për të drejtën për informim” dhe në përgjigje të kërkesës Tuaj me lëndë “Kërkohet Raporti i DSIK-së”, Datë 16.08.2022, nëpërmjet së cilës kërkohet Raporti i Kontrollit të Figurës hartuar nga DSIK, bashkëlidhur gjeni kopjen e Raportit si më poshtë: 1.Raporti i Kontrollit të Figurës nr. 12479, datë 02.11.2017, deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. 267 prot., datë 25.08.2022 të Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”.	E plotë	Nuk ka
19.	04.10.2022	Kërkesë për informacion E.Q	05.10.2022	Bazuar në ligjin 119/2014 “Për të drejtën për informim” dhe në përgjigje të kërkesës Tuaj më datë 04.10.2022 me lëndë “Kërkesë për informacion”, bashkëlidhur gjeni kopjen e Raportit si më poshtë: 1.Raporti i Kontrollit të Figurës nr. 11879, datë 31.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. 231 Prot., datë 11.09.2019 të Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”.	E plotë	Nuk ka
20.	30.09.2022	Kërkesë M.B dhe A.Q	05.10.2022	ne vijim te email-it tuaj nepermjet se ciles kerkoni informacion per "Raportin e Kontrollit te Figures", per subjektin e rivleresimit z. Skender Damini, me detyre ish-gjyqtar prane Gjykates se Apelit Vlore, ju bejme me dije se DSIK e ka marre ne shqyrtim kerkesen tuaj. Po ju bejme me dije si me poshte: • Z. Damini, ka dhene doreheqjen per ushtrimin e detyres si gjyqtar me date 17.11.2021 dhe Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) ka pranuar doreheqjen e tij, duke u shprehur me vendimin nr. 485, date 14.12.2021. Ky vendim eshte lene ne fuqi nga Kolegji i Posaçem i Apelimit (KPA) i cili eshte shprehur me vendimin	E plotë	Nuk ka

				<p>nr. 4, date 11.03.2022. Aktualisht, vendimi nr. 485, date 14.12.2021 ka marre forme te prere.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Raporti i Kontrollit te Figures nr. 13792, date 19.12.2019, eshte deklasifikuar pjeserisht me vendimin nr. 301, date 06.02.2020, nga Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvleresimit te informacionit te klasifikuar "Sekret shtetëror", ne DSIK dhe i eshte vene ne dispozicion Komisionit te Pavarur te Kualifikimit, i cili eshte organi qe administron dosjet e subjekteve te rivleresimit. <p>Per sa me siper, ju sugjerojme qe t'i drejtoheni Komisionit te Pavarur te Kualifikimit për të marrë një kopje të Raportit te siperpermendur.</p>		
21.	14.09.2022	Kërkesë për njohje me dosjen E.L	07.10.2022	<p>Në përgjigje të kërkesës Tuaj, protokolluar në DSIK me Nr. 28, datë 14.09.2022, nëpërmjet së cilës kërkoni ndihmë në lidhje me njohjen e dosjes Tuaj personale për një studim familjar dhe që ndodhet në QPR e Ministrisë së Mbrojtjes, ju bëjmë me dije se:</p> <p>-Bazuar në pikën 1, të nenit 3 dhe germën ç, të neni 5, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017 "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", Ju mund t'i drejtoheni Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar, krijuar me urdhër të titullarit të ministrisë që ka në administrim dosjen Tuaj personale, me qëllim që të vendosë për deklasifikimin e plotë, ose të pjesshëm të saj.</p>	E plotë	Nuk ka
22.	08.11.2022	Kërkesë për informacion V.K	14.11.2022	<p>Në përgjigje të shkresës Tuaj, me lëndë "Kërkesë" datë 08.11.2022, ku kerkoni "Numrin e dokumentave të klasifikuara sekret shtetëror, në kategoritë e ndryshme të sekretit shtetëror nga institucioni i Këshillit të Lartë Gjyqësor, të ndara sipas kategorive të klasifikimit apo formave të tjera të arshivimit që ju përdorni", Ju bëjmë me dije se: Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) nuk disponon të dhënat/evidencat e kërkuara nga ana juaj për informacionet e klasifikuara "Sekret shtetëror", që hyjnë apo dalin nga institucionet shtetërore. Lidhur</p>	E plotë	Nuk ka

				me këtë kërkesë drejtohuni Këshillit të Lartë Gjyqësor.		
--	--	--	--	--	--	--